



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**



**VENDIM**

Nr. 16, datë 02.04.2026

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË**  
**BASHKIAKE, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, e nenit 54 shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenit 6, shkronja “c” dhe nenit 9, të Ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, Ligjit nr.89/2022, “Për Policinë Bashkiake”, Vendimit nr.103, datë 11.02.2026 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufjeve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesem 2026-2028”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Policisë Bashkiake dhe Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

1. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake të Bashkisë së Durrësit, si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion	Shtesë për kushte të veçanta pune
1	Drejtor Drejtorie	1	123.000	
2	Përgjegjës Sektori	1	87.200	
3	Specialist	1/2	80.000	
4	Inspektor i Policisë Bashkiake	-	72.300	4.000
5	Punonjës i Policisë Bashkiake	-	66.000	4.000

- Shtesa për vjetërsi në punë për tabelën sipërcituar, për numrat rendorë 1,2 dhe 3 të jepet në masën:
  - i. 0.6 % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
  - ii. 0.8 (zero pikë tetë) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
  - iii. 1 (një) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- Shtesa për vjetërsi në punë për tabelën sipërcituar për numrat rendorë 4 dhe 5 të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.
- Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome është si më poshtë vijon:

Grupi i diplomë	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të
1	Niveli 7 i KSHK-së (Master i shkencave. Master i arteve. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14 000 lekë
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12 000 lekë
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	10 000 lekë

2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar 2026 dhe do të përballohen nga fondi rezervë për rritjen e pagave planifikuar në buxhetin e vitit 2026.
3. Vendimi nr.96, datë 28.10.2024 , i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake, Durrës”, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Policisë Bashkiake, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**

**Denisa Luarasi**



**U shpall sot me datë 03.04.2026**





BASHKIA DURRËS  
94/26 N. 4195/4 PROT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 246/6 prot.

Durrës, më 08.04.2026

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.16 datë 02.04.2026, "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake, Durrës.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI  
ADRIAN GURRA**

